

URDHËR
Nr.305, datë 8.5.2020

PËR MËNYRËN E VETËKARANTINIMIT TË PERSONAVE
QË RIATDHESOHEN

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1 gërma c, të ligjit nr.15/201, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Duke filluar nga data 11.5.2020 të gjithë shtetasit shqiptar që riatdhesohen në Republikën e Shqipërisë gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, do të vetëkarantinohen në banesë për një periudhe 14 ditore.
2. Mosrespektimi i detyrimit të përcaktuar në këtë urdhër për vetëkarantinim për 14 ditë të personave që riatdhesohen është i dënueshëm sipas legjislacionit në fuqi.
3. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor mbikëqyr zbatimin e urdhrit dhe vendos masën e gjobës, sipas legjislacionit në fuqi.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu